

Të nderuara Zonja dhe Zotërinj,

Instituti i Statistikave dhe Organizata Ndërkombëtare për Migracionin, prezanton sot një studim të thelluar mbi fenomenin e kthimit të emigrantëve shqiptarë gjatë viteve 2009-2013.

Fenomeni i emigrimit në shkallë të gjerë të popullsisë shqiptare, pas rënies së regjimit, ka qenë në përmasa të paprecedent në historinë e vendit. Gjithashtu, Censusi i Popullsisë dhe Banesave i vitit 2011 evidentoi jo vetëm një emigracion në vazhdimësi në shkallë të gjerë por gjithashtu edhe një rikthim me përmasa të konsiderueshme.

Nisur nga këto konsiderata, INSTAT dhe IOM bashkëpunuan të ndërmarrin këtë studim, rezultatet e të cilit po paraqesim sot përpara jush.

Synimi i këtij studimi është identifikimi i tipareve të emigrantëve të kthyer, shkaqeve të kthimit si dhe nevojat e tyre pas kthimit, me synimin e ndërtimit të politikave të nevojshme për të ndihmuar riintegrimin e tyre në shoqëri.

Studimi që ju po merrni në dorë tregon se rreth 134 mijë emigrantë janë kthyer në Shqipëri përgjatë periudhës 2009-2013. Ritmi i kthimeve është përsheptuar pas vitit 2011 me rreth 1,5 herë.

Studimi sugjeron se ashtu siç është perceptuar, kriza e thellë në ekonominë greke përgjatë gjashtë viteve të fundit si dhe stanjacioni i gjatë në ekonominë e Italisë ka shtyrë një pjesë jo të vogël të emigrantëve të mendojnë për ripozicionim të tyre si emigrantë në këto vende apo kthimin në shtëpi.

Gjetjet e të këtij studimi janë shumë të vlefshme për të ballafaquar me statistika perceptimet e përfituara me sy të lirë. Kështu, ndonëse ne dimë për shqiptarë të kthyer nga emigrimi që kanë hapur biznese të vogla në Shqipëri, statistikat e përfituara nga ky studim sugjerojnë se kjo është historia e një pjese të vogël të të kthyerve.

Ndër gjetjet më të rëndësishme të studimit është fakti që mosha mesatare e emigrantëve të kthyer është 38.6 vjeç. Emigrantët e kthyer në shumicë dërrmuese kanë nevojë për trajnime profesionale në mënyrë që të gjejnë një vend pune, apo që një pjesë e të kthyerve janë me

fëmijë në moshë të mitur, fëmijë që kanë nevojë për integrim në sistemin arsimor shqiptar. Gati gjysma e emigrantëve kanë pasur arsim të mesëm para se të emigronin dhe vetëm 5,1 përqind e tyre kanë kryer studime universitare ose pasuniversitare në vendin e emigrimit.

Një tjetër gjetje e këtij studimi është se se pjesa më e madhe e emigrantëve të kthyer mendojnë se eksperiencat e fituar në emigrim përbën avantazh për situatën pas rikthimit por nga ana tjetër rreth 40 përqind e tyre mendojnë se do të qëndrojnë në Shqipëri përgjithmonë, ndërsa rreth një e treta e shohin kthimin në Shqipëri si të përkohshëm dhe synojnë të emigrojnë përsëri.

Studimi që ju po merrni në dorë sot është një pikënisje e mirë për të identifikuar të gjithë gamën e problematikave, avantazheve dhe disavantazheve të procesit të kthimit të një pjese të emigrantëve në atdhe. Ne shpresojmë që ky studim do të shërbejë për konceptimin me efikasitet të politikave të reja apo përshtatjes së politikave ekzistuese për riintegrimin e emigrantëve të kthyer.

Gjej rastin nga ky komunikim me publikun, për të shprehur vullnetin dhe gatishmërinë e palëkundur të INSTAT për rritur edhe më tej bashkëpunimin me shoqërinë civile, mjedisin akademik, organizatat të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare, për t'i servirur publikut shqiptar studime të tilla të thelluara, të cilat kontribuojnë në kuptimin dhe shpjegimin më të mirë të fenomeneve të ndryshme sociale apo ekonomike që ndodhin në vendin tonë.

Ju faleminderit për vëmendjen!